



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Në datën 12. 12. 2016 Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) realizoi vizitë të pa paralajmëruar në Stacionin Policor Gjevgjeli (dy vizitat paraprake të realizuara nga ekipi i MPN në këtë stacion policor u zbatuan në datën 26. 06. 2012 dhe 14. 11. 2013).

Vizita e MPN në SP Gjevgjeli është konform mandatit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional i parashikuar me Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet realizimi i vizitave të rregullta në vendet ku personat mund të privohen nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor ose ndëshkues.

Vizita u realizua nga ekipi i MPN, në bashkëpunim me dy përfaqësues të Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe Shoqatës për të Drejtën Penale dhe Kriminologji të Republikës së Maqedonisë, në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, profesor të shkencave policore.

Nga këqyrja e zbatuar në kushtet materiale të Stacionit Policor Gjevgjeli, në pjesën e përdhësës së kësaj ndërtese, ekzistojnë dy hapësira për të mitur në të cilat zhvillohen bisedat dhe pranimi i të miturve.

Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se ky stacion policor i plotëson kushtet sa u përket hapësirave të veçanta për bisedë me personat e mitur të parashikuar me Ligjin për drejtësi për fëmijët.

Hapësira për ndalimin e personave gjenden në pjesën e bodrumit të stacionit policor dhe deri te të njëjtat arrihet nga dy anë: nga ana e jashtme, ku gjendet parkingu zyrtar i policisë dhe nga ana e brendshme, nëpër shkallë të cilat fillojnë nga zyra e kujdestarisë.

Në dy hapësirat e veçanta kolektive mund të vendosen njëkohësisht katër persona, ndërkaq të njëjtat janë rinovuar para 4 vjetëve në kuadër të Projektit për rinovimin e stacioneve policore në Republikën e Maqedonisë i mbështetur nga Bashkimi

Evropian. Pajisja në to është në përputhje me standardet e përcaktuara ndërkombëtare për këtë lloj të hapësirave.

MPN konstatoi se në hapësirën për ndalim udhëzimet/mësimet për të drejtat e personave të ndaluar janë theksuar me rregull në më shumë gjuhë. Interfoni për komunikim me hapësirën e zyrës kujdestare është funksional, brendia e hapësirës për ndalim është e ngrohur me ngrohje dyshemeje dhe me ngrohje qendrore, ndërsa lagështia e ajrit është në kufijtë e normales. Ekipi i MPN konstatoi se hapësirat janë të pastra dhe të rregullta pa prezencë të lagështisë dhe mykut në to.

Për këtë vizitë, Mekanizmi Parandalues Nacional hartoi raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime konkrete të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe komandantit të Stacionit Policor Gjevgjeli, me qëllim që të eliminohen mangësitë e vërejtura dhe të përmirësohen kushtet dhe trajtimi i personave të privuar nga liria, si dhe personave të arrestuar dhe të ndaluar.